

VENDIM
Nr.52, datë 3.8.2009

**PËR MIRATIMIN E MODIFIKIMIT TË LICENCËS SË PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE TË SHOQËRISË “FAVINA” 1 SHPK ME SERI PV05P, NR.29, LËSHUAR
ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR.85, DATË 27.12.2005**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikat 2.2, 2.3 dhe 2.5, si dhe nenet 12 dhe 15 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 3.8.2009, pasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “Favina 1” sh.p.k., për ndryshimin e licencës nr.29, seria PV05P, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.85, datë 27.12.2005 dhe informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, dhe konstatoi paraqitjen e plotë të dokumentacionit siç kërkohet nga rregullorja “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”,

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimin e licencës nr.29, seria PV05P, të shoqërisë “Favina 1” sh.p.k., për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.85, datë 27.12.2005 të mbajtur nga shoqëria “Favina 1” sh.p.k. duke shtuar në aneksin “A” të kësaj licence një agregat tjetër me kapacitet 1335 kW dhe duke ndryshuar kapacitetin total të HEC-it Vithkuq nga 780 kW në 2115 kW.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta